

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Isa Kelmendi dhe Jelena Krivokapiq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania “S.” A. ..., ..., të cilën me autorizim e përfaqëson B. N., avokat në ..., kundër të paditurës K. e S. ish “D.” me seli në ..., tani “E.” ..., për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.91/2016 datë 31.08.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 08.01.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.91/2016 datë 31.08.2018.

Aprovohet si i bazuar revizioni i të paditurës vetëm sa i përket vendimit për kamatën e aprovuar, dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.91/2016 datë 31.08.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr.506/2012 datë 08.02.2016, ashtu që shumën e gjykuar me këto aktgjykime në lartësi prej 50.858,62 €, detyrohet e paditura që paditëses t’ia paguajë me kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 24.01.2012 e tutje deri në përmbushjen përfundimtare të këtij borxhi.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr.506/2012 datë 08.02.2016, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar ish e paditura K. e S. “D.” me seli në ... që në emër të regresit paditësit t’i paguaj shumën e përgjithshme në lartësi prej 50.858,62 €, me kamatë në lartësi

prej 20%, duke filluar nga data 16.05.2011 si ditë e paraqitjes së padisë e deri më datën 29.07.2011, ndërsa nga kjo datë e deri në përmbushjen definitive, me kamatë vjetore prej 12 %, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 4.026,02 €.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.91/2016 datë 31.08.2018 është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës vetëm sa i përket lartësisë së kamatës së gjykuar me aktgjykimin e lartpërmendur , ashtu që në këtë pjesë i njëjti aktgjykim është ndryshuar dhe është detyruar e paditura që në shumën e aprovuar në lartësi prej 50.858,62 €, paditësit t'i paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në bankë mbi 1 vit e pa destinim të caktuar me një dënim shtesë prej 20% të normës së kamatës vjetore, duke filluar nga data 16.05.2011 e deri më datën 29.07.2011, ndërsa nga data 30.07.2011 e deri në pagesën definitive, paditësit do t'i paguaj kamatën në lartësi prej 12 % në vit. Në pjesët tjera i njëjti aktgjykim është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë , e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe tejkallimit të kërkesëpadisë, me propozim që të ndryshohet të dy aktgjykimet e lartpërmendura ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar ose të njëjtat aktgjykime të prishen dhe lënda të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësja në përgjigje në revizionin e të paditurës kontestoi thëniet e revizionit dhe propozoi që revizioni i të paditurës të refuzohet si i pabazuar përveç në pjesën e vendimit lidhur me kamatën e gjykuar për të cilën pjesë propozoi ndryshimin e të njëjtit aktgjykim ashtu që të mbetet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me parashtrësën elektronike të datës 24 janar 2012, paditësi nga e paditura ka kërkuar që për pagesat e paditësit të bëra personit të dëmtuar-M. H., si i siguruar i saj, të arrihet pajtimi jashtëgjyqësor duke filluar me një ofertë minimale të zakonshme si në rastet e trajtuara më parë, me vërejtje që nëse deri më datën 10.02.2012, lidhur me këtë kërkesë nuk ka përgjigje nga e paditura në formë të ndonjë oferte , do të

kuptohet që nga ana e të paditurës nuk ka gatishmëri që në procedurë të rregullt të përmbillet ky rast. Në këtë parashtrësë të paditësit, e paditura është përgjigjur se nuk ka ndonjë obligim ndaj paditësit pasi që në procedurë jashtëgjyqësore personit të dëmtuar M. H. ia ka kompensuar dëmin e shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 26.07.2010, në Rahovec. Për këtë arsye, paditësi më datën 22.11.2012, ka paraqitur padi kundër të paditurës duke kërkuar regresimin e borxhit në lartësi të cilën në Zvicër ia ka paguar të dëmtuarit-të siguarit të saj M. H., për shkak të lëndimeve të pësuar në aksidentin e lartpërmendur të komunikacionit të shkaktuar në Kosovë. Borxhi i kërkuar ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve të trajtimit mjekësor për të dëmtuarin M. H., dhe kompensimin për paaftësinë e tij për punë gjatë mjekimit nga baza e sigurimit të auto përgjegjësive, në shumë të përgjithshme prej 50.858,62 €, me kamatë prej 20%, duke filluar nga data 16.05.2011 e deri me datën 29.07.2011, e që nga kjo datë e fundit e deri në pagesën definitive me kamatë ndëshkuese prej 12%, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit pasi që ka gjetur se shkaktar ekskluziv i aksidentit të ndodhur më datën 26.07.2010, ishte ngasësi i automjetit të siguar tek e paditura, i markës “D Benz” me targa kosovare ..., të cilën e drejtonte O. D. Në këtë aksident lëndime trupore kishte pësuar M. H., i siguar tek paditësja në Zvicër. Nga raporti i pagesave-bordero nr.1140633.10.7 të datës 16.07.2012, dhe nga konvertimi CH/euro nga data 22.01.2016, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se i dëmtuari M. H., në emër të trajtimit mjekësor dhe për periudhën e paaftësisë në punë ka pësuar dëm në shumën prej 50.858,62 €, të cilën shumë paditësi ia ka paguar të lënduarit M. H., si i siguar i saj. Bazuar në dispozitat e nenit 300 dhe 939 të LMD, gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore pjesërisht ka pranuar si të bazuar ankesën e të paditurës ashtu që ka ndryshuar aktgjykimin e lartpërmendur vetëm në pjesën e vendimit lidhur me kamatën e gjykuar dhe ka vendosur përkitazi me kamatën si në dispozitiv të aktgjykimit të saj në kuptim të nenit 277 të LMD dhe nenit 5.1 të Rregullit III të BQK, të datës 18 tetor 2001. Ndërsa në pjesën tjetër i njëjti aktgjykim është vërtetuar, për arsye të dhëna më afër në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Qenësore është se edhe gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se paditësi ka të drejtë në regresimin e asaj shume që ia ka kompensuar të dëmtuarit Miftar Hoti, në kuptim të nenit 190 të LMD.

Në një gjendje të tillë të çështjes , Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësit sa i përket lartësisë së regresimit të borxhit në shumë prej 50.858,62 €, kjo nga se këto aktgjykime në këtë pjesë nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Objekt shqyrtimi ishin pretendimet e revizionit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 203 të LPK, që ka të bëjë me mosrespektimin e parimit reformacio in peius, që ka të bëjë me ndalimin që i referohet gjykatës së shkallës së dytë që të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në dëm të palës ankuese , poqë se vetëm ajo ka bërë ankim, e jo edhe pala kundërshtarë. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme , ky parim i procedurës kontestimore nuk është cenuar, andaj edhe nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të kësaj dispozite ligjore pasi që me vendimin e gjykatës së shkallës së dytë është ndryshuar vendimi për kamatën në favor të paditurës. Në këtë drejtim u refuzuan si të pabazuara edhe pretendimet e revizionit të cilat pretendojnë se është bërë tejkalimi i kërkesëpadisë, i cili shkak i paraqitjes së revizionit as që është elaboruar më konkretisht në revizionin e të paditurës.

Gjykata Supreme shqyrtoi edhe pretendimet tjera të revizionit përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale të cilat kanë të bëjnë me insistimin e të paditurës se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për subrogim. Ky kundërshtim është paraqitur edhe në ankesë, për refuzimin e të cilit edhe gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të pranueshme për gjykatën e revizionit, të cilin arsyetim nuk ka nevojë që kjo gjykatë ta ri përsërit , mirëpo vlen të theksohet se në rastin konkret dëmi i kompensuar, sipas përmbajtjes së provave në shkresat e lëndës lidhet drejtpërsëdrejti me ngjarjen dhe pasojat të cilat i dëmtuari M. H., i ka pësuar në aksidentin e lartpërmendur të komunikacionit , andaj në kuptim të nenit 190 të LMD të vjetër, gjykata duke marrë parasysh edhe rrethanat që kanë lindur pas shkaktimit të dëmit do të gjykojë kompensimin në një shumë që nevojitet që gjendja materiale e dëmtuesit të sillet atje ku do të ishte po të mos kishte veprim dëmtues ose lëshim. Në nenin 300 të LMD-së, i cili ka qenë në fuqi në kohën e ndodhjes së aksidentit, parashihet që “kur detyrimin e përmbush personi që ka ndonjë interes juridik në këtë, atëherë i kalohet këtij , në bazë të vet të drejtës , në momentin e përmbushjes , kërkesa e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore”. Kjo do të thotë se nuk mund të bëhet fjalë për mos plotësimin e kushteve ligjore për subrogim, andaj në

kuptim të nenit 939 të njëjtit ligj deri në shumën e kompensimit të paguar, paditësi ka të drejtë të kërkojë nga e paditura pagesën e bërë.

Mirëpo, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë në pjesën lidhur me kamatën e gjykuar përfshihet me zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 277 të LMD- të vjetër në lidhje me nenin 26.7 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur nga Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011.

Zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, qëndron në faktet se, si është thënë më lartë, kërkesa e paditësit për kompensim si dhe padia është paraqitur në kohën kur ka hyrë në fuqi Ligji i lartpërmendur për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Andaj kamata e aprovuar nga gjykata e shkallës së dytë dhe gjykata e shkallës së parë , ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për regresim borxhi, por vetëm për vonesa të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblimin e dëmit në procedurë jashtë gjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 26 të Ligjit të lartpërmendur dhe nenin 5.1 të Rregullit të BQK-së nr.3 mbi ndryshimin e rregullit për sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësive të datës 25 shtator 2008, në të cilat dispozita thirret gjykata e shkallës së dytë. Ato kamata të cilat i ka aplikuar gjykata e shkallës së parë dhe e dytë janë të parapara me qëllim të disiplinimit të kompanive siguruese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të personave të dëmtuar , të cilat kërkesa kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brenda afateve të parapara sipas dispozitave të lartpërmendura.

Paragrafi 7 i nenit 26 të Ligjit të lartpërmendur përjashton zbatimin e kamatës prej 12% edhe për regresim borxhi , kamatë kjo e paraparë vetëm për mos trajtimin dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar, për dëm shpërblim. Kështu që, pa dyshim rezulton se paditësi ka të drejtë vetëm në kamatën e thjeshtë, e jo edhe në kamatë “të kualifikuar” sipas dispozitave të cituara nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë. Meqë paditësja me parashtrësën e datës 24.01.2012, ka kërkuar regresim të borxhit nga e paditura , rezulton se nga kjo datë e paditura ka rënë në vonesë në kuptim të nenit 324.2 të LMD të vjetër i cili atëherë ka qenë në fuqi, sipas të cilës *debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar për përmbushje, ndërsa kur afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori ta ftojë që ta plotësojë detyrimin e vet, verbalisht ose me shkrim , me paralajmërim jashtë gjyqësor, ose duke filluar ndonjë procedurë, qëllimi i të cilës është realizimi i përmbushjes së detyrimit.* Nga kjo rezulton se

paditësi në kuptim të nenit 277.1 të Ligjit të lartpërmendur ka të drejtë që ndaj debitorit-këtu të paditurës i cili është vonuar me përmbushjen e borxhit në të holla, të kërkojë përveç lartësisë së borxhit edhe kamatën e cila paguhet si për deponimet në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të përcaktuar, duke filluar nga dita e rënies së të paditurës në vonesë përkitazi me pagesën e borxhit kontestues . Përndryshe sipas nenit 1057 të LMD të Republikës së Kosovës , dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Meqë dëmi ka ndodhur në kohën e vlefshmërisë së LMD të vjetër atëherë dispozitat e atij ligji zbatohen në përgjithësi, e në veçanti edhe për kamatën, nga se neni 1057 nuk përjashton nga zbatimi vetëm dispozitat për kamatën por tërë Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve të Republikës së Kosovës kur marrëdhëniet e detyrimeve kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, andaj në rastin konkret nuk mund të gjykohet asnjë lloj tjetër i kamatës përveç asaj të aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kështu që për këto arsye në këtë pjesë të dy aktgjykimet e lartpërmendura u desh që të ndryshohen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme vlerësoi edhe pretendimet e paditësit të paraqitura në përgjigje në revizionin e të paditurës dhe gjeti se në bazë të tyre nuk mund të vendosej ndryshe lidhur me revizionin e të paditurës. Për arsyet e paraqitura më lartë , nuk mund të pranohej as propozimi i paditësit që përkitazi me kamatën të mbetet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, me që në këtë pjesë, si u tha më lartë edhe ky aktgjykim ishte i përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe për konsekuencë juridike në atë pjesë për shkaqet e thëna më lartë edhe ai aktgjykim u desh të ndryshohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë dhe me zbatimin e nenit 221 dhe 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

E.Rev. 39//2018 datë 08.01.2019

Kryetar i kolegjit,
Shukri Sylejmani